




REPubLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 92/10

Nr. i fq. / Br. st _____

Data: / Datum 29. 06. 2010

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS VUSHTRRI


RREGULLORE

mbi caktimin e kriterëve të përfituesëve në material ndërtimor për
ndërtimin, meremetimin e objekteve banesore – shtëpive

Prill 2010



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN



Rr. "Adem Jashari" nr.1, Tel.028/571-524, Fax 028/571-232, E-mail: sekretaria_kkvush@yahoo.com

Në bazë të nenit 12 pika "c" të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 31.2, "a" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e vetë të mbajtur më 29.04.2010, miraton këtë:

RREGULLORE

Mbi përcaktimin e kritereve të përfituesëve në material ndërtimor për ndërtimin, meremetimin e objekteve banesore-shtëpive

I.DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Qëllimi

Neni 1

- 1.1. Me këtë Rregullore përcaktohen kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së përfituesëve në material ndërtimor për ndërtimin, meremetimin e objekteve të banimit në territorin e Komunës së Vushtrrisë

II. KUSHTET PËR APLIKIM

Neni 2.

- 2.1. Kategorit që kanë të drejtë të aplikojnë për material ndërtimor për ndërtimin, meremetimin e objekteve të banimit janë familjet që:
- a) Janë banorë të komunës dhe duhet të kenë dokumente valide të identifikimit,
 - b) Nuk kanë banesë apo shtëpi në pronësi individuale,
 - c) Kanë mbetur të pastrehë/jetojnë në qendra të përkohshme kolektive,
 - d) Kanë mbetur të pastrehë si pasojë e luftës dhe nuk kanë përfituar nga programi i rindërtimit,
 - e) Të ketë patundshmëri-truall për ndërtim, aplikuesi ose anëtari i familjes.
 - f) Familjet që jetojnë në kushte të vështira të banimit.

III. KRITERET PËR PËRZGJEDHJE

Neni 3.

3.1. Kriteret për përzgjedhje për ndërtimin apo meremetim janë:

- a) Familje e kryesuar nga femrat – burri i vrarë gjatë luftës,
- b) Fëmijë pa prindë,
- c) Familje me më shumë se tre fëmijë,
- d) Familje e kryesuar nga femrat-e nënat vetëushqyese burri i ka vdekur,
- e) Individët me aftësi të kufizuar, invalidët e luftës, invalidët e punës,
- f) Familjet të cilat kanë invalid ose veteran të UÇK-ës.

IV. KRITERET SHITESË PËR VLERËSIM

Neni 4.

4.1. Kushtet aktuale të banimit

- 4.1.1. Koha e qëndrimit të familjeve në qendra kolektive,
- 4.1.2. Koha e qëndrimit të shtëpive para dëmtimit të tërsishëm,
- 4.1.3. Koha e qëndrimit të familjeve në kamp-shtëpiza, baraka.

4.2. Prona dhe pasuria të cilat e përjashtojnë aplikuesin-kërkuesin janë:

- 4.2.1. Pronësia e ndonjë njësie banuese, afariste apo ndonjë prone të patundëshme që përdoret si banim primat i ndonjë antari të familjes.
- 4.2.2. Të hyrat nga punësimi apo ndonjë veprimtari tjetër apo lloj ndihme,
- 4.2.3. Pronësia e tokës e cila është mbi 0.50.00 ha.
- 4.2.4. Nga kriteret e parapara me nenin 4.2.2 dhe 4.2.3, përjashtohen familjet e dëshmorëve dhe veteranet e luftës së UÇK-ës.

4.3. Struktura e familjes ose individit që ka përparësi në përfitim material:

- 4.3.1. Personat e moshës 0-5 vite që kanë nevojë për përkujdesje të plotë,
- 4.3.2. Personat ndërmjet moshës 6-18 vjeçarë që janë në shkollim,
- 4.3.3. Personat ndërmet moshës 18-65 vjeçarë.

4.4. Gjendja shëndetësore e aplikuesit ose e familjës së tijë.

- 4.4.1. Personat me nevoja të veçanta.
- 4.4.2. Personat me shkallë të invaliditetit prej 81-100%.
- 4.4.3. Personat me shkallë të invaliditetit prej 61-80%.
- 4.4.4. Personat me shkallë të invaliditetit prej 40-60%.

V. PROCEDURA PËR APLIKIM DHE PËRZGJEDHJE

Neni 5.

5.1. Autoriteti komunal bënë shpalljen publike e cila duhet të përmbajë:

- 5.1.1. Të dhënat që duhet ti plotësojë aplikuesi në kërkesë,
- 5.1.2. Dokumentacionin e nevojshëm,
- 5.1.3. Sasia e materialit për ndërtim-meremetim,
- 5.1.4. Afati i të drejtës për aplikim,

5.2. Marrja e aplikacioneve pranë autoritetit komunal

5.3. Dorëzimi i aplikacionit nga aplikuesi dhe detyrat e autoritetit komunal janë:

- 5.3.1. Të kontrollojë dokumentet e aplikimit, nëse janë complete,
- 5.3.2. Të regjistrojnë dokumentet që i bashkangjiten aplikacionit,
- 5.3.3. të kërkojë kopjet e dokumenteve nëse nuk janë origjinale të vërtetohen.

5.4. Formimi i komisionit për vlerësim dhe përzgjedhje

- 5.4.1. Kryetari i Komunës duhet të formojë komision për përzgjedhje.
- 5.4.2. Përbërja e komisionit të jetë nga administrata komunale në përbërje prej 3-5 anëtar.
- 5.4.3. Komisioni është i obliguar ti përmbahet kësaj rregullorje,
- 5.4.4. Komisioni është i obliguar që të gjitha të dhënat ti verifikojë në teren.
- 5.4.5. Vlerësimi i familjeve apo individit që kanë përfituar publikohet në tabelën e shpalljeve në afat prej 30 ditësh.

PROCEDURA E ANKESAVE

Neni 6.

- 6.1. Afati kohor për ankim për të gjitha ato familje apo aplikuesëve

- që nuk kanë përfituar material ndërtimor apo ndihmë për meremetim është 30 ditë nga dita e pranimi të aktit.
- 6.2. Kur ankimi bëhet në formën e kërkesës për rishqyrtim ai dorëzohet te organi që e ka nxjerr aktin.
- 6.3. Kur ankimi bëhet në formë të ankesës, ai dorëzohet te organi më i lartë.

VI. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 7.

- 7.1. Për të gjitha të metat-zbrazësit që paraqiten në këtë rregullore, Do të mbisundojnë dispozitat ligjore në fuqi,

Hyrja në fuqi

Neni 8.

- 8.1. Kjo rregullore hynë në fuqi në ditën emiratimit në Kuvendin e Komunës së Vushtrisë.



Prezuesi i Kuvendit

Rexh Idrizi
Rexh Idrizi